

6431 Schwyz, Postfach 2161

Për prindërit
e fëmijëve që ndjekin shkollën në Kantonin Schwyz

albanisch

E-Mail kad.ags@sz.ch
Direktwahl 041 819 13 66
Datum 30. Juni 2025



Orientim mbi kujdesin e dhëmbëve në shkollë

Të dashur prindër

Ruajtja e shëndetit të dhëmbëve të fëmijëve tuaj është një detyrë e rëndësishme, me të cilën ju si prindër përballeni vazhdimisht. Shkolla mbështet përpjekjet tuaja përmes kujdesit dentar në shkollë. Instruktoret e kujdesit dentar në shkollë vizitojnë çdo vit pothuajse të gjitha klasat dhe u shpjegojnë nxënësve se si të parandalojnë kariesin dhe të mbajnë dhëmbët e tyre të shëndetshëm nëpërmjet:

1. Kufizimit të konsumit të sheqerit: Sheqeri është armiku më i madh i dhëmbëve.
2. Higjienës së gojës dhe pastrimit të dhëmbëve: Një dhëmb i pastër rrallë bëhet i sëmurë.
3. Përdorimit të fluoridit: Përdorni pastë dhëmbësh me përmbajtje fluori* dhe kripë të kuzhinës.

Gjithashtu, e rëndësishme për shëndetin e dhëmbëve është vizita e rregullt te dentisti. Prandaj, çdo vit ju merrni një kupon për një kontroll falas te një dentist që ju e zgjidhni vetë. Ky kupon i bashkëngjitur mund të përdoret edhe për trajtime të tjera dentare.

Shpresojmë që me këtë të japim një kontribut të rëndësishëm për shëndetin e dhëmbëve dhe mirëqenien e nxënësve tanë.

Me respekt

Departamenti i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Dr. med. dent. Michael Krähenmann
Dentisti Kantonal

*Në Kopshte – pastë dhëmbësh për fëmijë me fluorid 0.05% ose 500 ppm Fluorid / Në Shkolla – pastë dhëmbësh «Junior» ose «normale» me fluorid 0.15% ose 1500

Printimi i kuponit të bashkëngjitur u financua nga Shoqata e Dentistëve SSO e Kantonit Schwyz.